



Kryetarja e Komunës
01 Nr. 116-21952 /2016
Datë: 21.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 69, alinea 1, paragrafi 1.1, i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 21.04.2016, merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi znj. Valbona Naka, e caktuar në vendin e punës - Udhëheqëse e Kadastrit për Çështje Juridike pran Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Gjakovës, për shkak se kundër saj nga Gjykata Themelore - Departamenti për Krime të Rënda është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, **pezullohet menjëherë nga detyra deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata;**
2. Nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata;
3. Punëdhënësi pas përfundimit të procedurës gjyqësore do të veprojë sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
4. Ky vendim hyn në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Komunës.

T`iu dorëzohet:

- Nëpunësit në fjalë
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Drejtorisë për Buxhet e Financa / Shërbimi i pagesave
- Udhëheqësit të Personelit, dhe
- Arkivit

KRYETARJA E KOMUNËS,


Znj. Mimoza Kusari-Lila